



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Adresa : Blvd. "Zogu I", Tirane, Shqiperi

64

6003

6003

26

6003

URDHËR

Nr. 3252, Datë 15.05. 2005

PËR

**"MIRATIMIN E RREGULLAVE TË SJELLJES PËR PUNONJËSIT E
SISTEMIT TË PARABURGIMIT DHE TË BURGJEVE"**

Mbështetur në nenin 102/4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në
nenet 3, 7/2 dhe 16 të Ligjit nr. 8678, datë 14.05.2001 “Për organizimin dhe
funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë” i ndryshuar,


URDHËROJ:

1. Miratimin e “Rregullave të Sjelljes për punonjësit e Sistemit të Paraburgimit
dhe të Burgjeve”, bashkëlidhur këtij Urdhëri.
2. Për zbatimin e këtij urdhëri ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
dhe strukturat në varësi të saj.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

FATMIR XHAFAJ



“RREGULLAT E SJELLJES PËR PUNONJËSIT E SISTEMIT TË PARABURGIMIT DHE BURGJEVE”

Duke patur parasysh qëllimet e shpallura në Kartën e Kombeve të Bashkuara për promovimin dhe inkurajimin e respektimit për të drejtat e njeriut dhe lirive themelore pa dallime për shkak të racës, seksit, gjuhës apo besimit fetar,

Duke iu referuar Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe Deklaratës për Mbrojtjen e të Gjithë Personave kundër Torturës dhe Trajtimeve të Tjera Mizore, Cnjerëzore apo Poshtëruese,

Të ndërgjegjshëm që natyra e funksioneve të punonjësve që zbatojnë ligjin dhe mënyra se si ushtrohen këto funksione ka ndikim të drejtëpërdrejtë në cilësinë e jetës së individit por edhe të shoqërisë në tërësi,

Ministri i Drejtësisë miraton “Rregullat e Sjelljes për punonjësit e Sistemit Paraburgimit dhe të Burgjeve” që punojnë në strukturat dhe institucionet në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Mosrespektimi i këtyre Rregullave konsiderohet mospërbushje apo shkelje ndaj detyrës shtetërore.

NENI 1 Parime të përgjithshme

Punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve kryejnë detyrat e tyre duke mbrojtur të drejtat e personave të privuar nga liria nga veprimet e paligjshme, me shkallë të lartë të përgjegjësisë dhe në përputhje kërkesat e legjislacionit në fuqi.

NENI 2 Mbrojtja e dinjitetit të personave të privuar nga liria

Në realizimin e detyrave që u ngarkon ligji, punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve do të respektojnë dhe mbrojnë dinjitetin njerëzor si dhe do të përkrahin respektimin e të drejtave të cdo personi të privuar nga liria.

NENI 3

Ndalimi i torturës apo trajtimit jonjerëzor

Punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve nuk duhet të lejojnë, nxisin apo shkaktojnë akte të torturës, të trajtimit jonjerëzor apo poshtërues ndaj personave të privuar nga liria.

NENI 4

Ndalimi i diskriminimit

Gjatë ushtrimit të detyrës, punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe burgjeve nuk duhet të lejojnë ose kryejnë asnje akt diskriminimi për shkak të racës, besimit fetar, origjinës, gjinisë, moshës, kulturës, kufizimeve fizike dhe prirjeve seksuale.

NENI 5

Ruajtja e sekretit profesional

Për detyrat me natyrë të rezervuar punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe burgjeve duhet të ruajnë sekretin me përjashtim të rastit kur urdhërohen apo udhëzohen me shkrim nga autoriteti përkatës dhe kompetent i parashikuar në ligj.

NENI 6

Mbrojtja e shëndetit

Punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve duhet të garantojnë mbrojtje të plotë të shëndetit të personave në kujdesin e tyre dhe në vecanti duhet të marrin masa të menjëherëshme si dhe të sigurojnë përkujdesje mjekësore kur është e nevojshme.

NENI 7

Ndalimi i akteve korruptive

Punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve nuk duhet të kryejnë akte korruptive si dhe duhet t'u kundërvihen dhe të luftojnë akte të ngjashme.

NENI 8

Respektimi i akteve ligjore dhe nënligjore

Punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve në punën e tyre duhet të respektojnë aktet ligjoredhe nënligjore në fuqi si dhe këto Rregulla. Ata duhet të përpiken gjithnjë duke bërë të gjitha përpjekjet duke iu kundërvënë dhe parandaluar shkeljen e tyre.

Kur ata kanë arsyet e besojnë që po kryhet ose do të kryhet ndonjë shkelje e këtyre Rregullave, duhet të raportojnë tek eprori i drejtëpërdrejtë në institucion dhe, kur është e nevojshme, tek autoritetet apo organet e tjera me kompetenca shqyrtimi apo rregullimi.

NENI 9

Marrëdhëni midis personelit dhe paraburgosurve/dënuarve

Në rastet kur ndërmjet pjestarëve të personelit në institucion krijohet një marrëdhënie dashurie, njoftohet menjëherë eprori i drejtpërdrejtë në institucion dhe në varësi të rëndësisë që paraqet ky raport në detyrën, njëri nga punonjësit e përfshirë transferohet në një institucion tjetër.

Kur një marrëdhënie e tillë ekziston ndërmjet një pjestari të stafit dhe një të dënuarve apo paraburgosurve ose familjari të afërt të tyre, punonjësi është i detyruar të njoftojë menjëherë eprorin e drejtëpërdrejtë dhe ky punonjë mund të transferohet nga ky institucion.

Janë kategorikisht të ndaluara dhe dënueshme ngacmimë të natyrës seksuale, qofte fizike apo verbale si për punonjësit e personelit të institucionit ashtu edhe ndaj të paraburgosurve ose dënuarve.

NENI 10

Papajtueshmëria dhe konflikti i interesit

Kur midis një pjestari të stafit dhe një të dënuari apo paraburgosuri në të njëjtin institucion ekzistojnë lidhje farefisnore apo të gjakut deri në shkallë të dytë, lidhje e cila ndikon në mbarëvajtjen dhe kryerjen e detyrës, eprori mund të vendosë që punonjësi apo i paraburgosuri/i dënuari të transferohet në një institucion tjetër, duke marrë në konsideratë edhe detyrën që ka ky punonjës.

NENI 11

Sjellja etike në institucion

Marëdhëni ndërmjet punonjësve në institucionet duhet të bazohen në respektin e ndërsjelltë dhe në ruajtjen e personalitetit të punonjësit të sistemit të paraburgimit dhe burgjeve.

NENI 12

Paraqitja e punonjësve

Punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve duhet të mbajnë paraqitje të rregullt dhe veshje serioze në përputhje me natyrën e punës së tyre për të përfaqësuar sa më denjësisht institucionin ku punon.

**NENI 13
Zbatimi i detyrave**

Kur një punonjësi të sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve i kërkohet tē zbatojë një urdhër apo detyrë që është në kundërshtim tē hapur me ligjin dhe normat pér tē drejtat e njeriut, nuk është i detyruar ta zbatojë atë dhe duhet tē vërë nē dijeni eprorin më tē lartë.

**NENI 14
Dhuratat dhe favoret**

Punonjësi i sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve nuk duhet tē kërkojë ose pranojë, dhurata, favore, privilegje, ose premtimë financiare pér veten, familjen apo tē afërmët, nga persona që kanë lidhje direkte ose indirekte me funksionet e tij dhe që ndikojnë ose duket sikur ndikojnë nē paanësinë e kryerjes së detyrës.

**NENI 15
Veprimtaritë e jashtme**

Punonjësi i sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve nuk duhet tē angazhohet nē veprimtari tē jashtme ose te kryejë aktivitete tē tjera që pengojnë kryerjen e detyrës së tij shtetërore ose që kërkojnë angazhim mendor a fizik tē tij që e bën tē vështirë kryerjen e detyrës, apo që cënon imazhin e punonjësit tē sistemit tē paraburgimit dhe burgjeve.

Në rastet e kryerjes së këtyre veprimtarive, punonjësi duhet tē njoftojë paraprakisht eprorin e drejtëpërdrejtë dhe nē rast mos aprovimi ka tē drejtë t'i drejtohet eprorit me tē lartë.

**NENI 16
Njohja me Rregullat e Sjelljes**

Punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe burgjeve duhet tē njihen me këto Rregulla tē cilat shpallen nē institucionet e paraburgimit dhe tē burgjeve nē varësi tē Drejtorisë së Përgjithshme tē Burgjeve.